



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0942

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE “Letamed Sh.P.K”, kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me karrika Stomatologjike dhe pajisje tjera” me numër të prokurimit 651-23-10457-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Kuvendi Komunal- Gjilan”, më 01.02.2024, mori këtë:

Vendim

1. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e “Letamed Sh.P.K” me nr. 2023/0942 , e datës 24/11/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me karrika Stomatologjike dhe pajisje tjera”, me numër të prokurimit 651-23-10457-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Kuvendi Komunal- Gjilan”.

2. Vërtetohet Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues – “Kuvendi Komunal- Gjilan” lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 05.10.2023, “Kuvendi Komunal- Gjilan” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me karrika Stomatologjike dhe pajisje tjera” me numër të prokurimit 651-23-10457-1-2-1. Ndërsa me datën 10.11.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka

shpërblyer me kontratë “Pro medical SH.P.K”

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës **49,000.00 €**

Me 14.11.2023, OE “Letamed Sh.P.K” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 16.11.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të jashtafatshmekërkesën për rishqyrtim.

Me 24.11.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Letamed Sh.P.K” me nr. 942/23 lidhur me aktivitetin “Furnizim me karrikaStomatologjike dhe pajisje tjera” me numër të prokurimit 651-23-10457-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Letamed Sh.P.K” janë parashtruar si në vijim:

Sqarim “AK me date: 10.11.2023 na ka dërguar njoftim vendimin B58 dhe Letrën standarde si tenderueses i eliminuar.

Pasi kemi analizuar vendimin e AK të datës 10.11.2023, dhe duke marr parasysh faktin se ne jemi OE i përgjegjshme me çmimin me të lire, kemi kërkuar qasje ne ofertën e OE te rekomanduar. AK sipas kërkesës sonë, na ka ofruar qasjen me date 14.11.2023. Ne qasjen e ofruar AK ka refuzuar te na jep dëshmitë e OE siç janë kërkuar nga ana jone. Andaj ne në këtë kërkesë për Rishqyrtim kemi këto pretendime Ankimore:

Pretendimi Nr.1 “Fillimisht pretendimi ynë ankimore ka te beje me atë qe Kërkesën Për Rishqyrtim të cilën ne e kemi dorëzuar me date: 14.11.2023, AK na ka refuzuar si kërkesë jashtë afatit !!! Vendimi i AK është publikuar me date: 10.11.2023, (Dite e premte), dita zero (0), dhe konform Rregullores për prokurim publik (neni 42.7), nëse Vendimi ka te beje me dhënie, dhe i njëjti publikohet ditën e premte numërimi fillon nga dita e premte si dite zero (0). Afati për dorëzim të kërkesave për rishqyrtim ka qene deri me date:15.11.2023, ndërsa ne kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim me date 14.11.2023, qe i bie brenda afatit ligjor (një dite përpara). Pra AK ka bere shkelje te nenit: 42 pika 7 te rregullores për prokurim publik.”

Pretendimi Nr.2 “Qasja e ofruar nuk është konform nenit 11 te LPP-se, sepse OE ne ANEKS3 të DT ka plotësuar kërkesën ku ka specifikuar se dokumentet si sekret afarist janë: 1.Autorizimet, 2.Katalogjet dhe 3.Lista e projekteve. Pra vete OE ne këtë aneks, si sekret afarist i ka vlerësuar vetëm 3 dokumente, ndërsa ne procesverbalin e datës 14.11.2023 për qasjen e ofruar, shihet se AK nuk na ka dhënë qasjen ne asnjë

prej dëshmime të tjera. Nëse kërkesa ishte për këto tri dokumente, atëherë pse AK nuk na ka ofruar qasjen për dëshmitë tjera. Ne natyrisht se e kemi përgjigjen për këtë qeshtje të cilën po ua prezantojmë ne pretendimet ne vazhdim”.

Pretendimi Nr.3 “Ne si OE i cili kemi ofruar çmimin me të lire nga të gjithë OE, përveç që kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-se, po ashtu ju kemi përmbajtur dhe kemi plotësuar të gjitha kërkesat për specifikimet teknike të kërkuara, duke ofruar dëshmitë, nga të cilat AK ka munde të vërej se pajisjet e ofruara nga ne, janë konform specifikimeve teknike të kërkuara ne dosje të tenderit. Pra AK me refuzimin e ofertës sonë, si OE i përgjegjshëm me çmimin me të lire, ka shpërblyer me kontrate një OE me çmimin me të shtrejt se të gjithë OE ne këtë procedure dhe ka DEMTUAR buxhetin e tije ne vlere prej: 14,250.00 euro.”

Pretendimi Nr.4 “OE i rekomanduar, përkundër që AK nuk na ka ofruar qasje, por ne e njohim si konkurrent dhe ne disa AK (si shembull ne AK Komuna Rahovec) kemi patur qasje ne ofertën e këtij OE dhe ky OE te cilin Komuna e Gjilanit e ka propozuar për kontrate, ka ofruar Autorizimin nga prodhuesi - nga një PRODHUES tjetër, ndërsa Certifikatat ISO dhe CE, i ka te një Prodhuesi tjetër. Pra nëse Komuna do ta bënte vlerësimin konform nenit 59 te LPP-se, do ta vërente se AUTORIZIMI, KATALOGU dhe Certifikatat ISO se bashku me CE Certifikatat nuk përputhen sepse janë te prodhuesve të ndryshëm.” Pra AK Komuna e Gjilanit përveç që na ka eliminuar neve ne kundërshtim me nenin 59 te LPP-se, ka vepruar ne kundërshtim me nenin Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi dhe ne kundërshtim me nenin 69 të LPP-së, sepse ka rekomanduar për kontrate një OE te pa përgjegjshëm dhe me vendimin e datës 10.11.2023 ka dëmtuar buxhetin e tije ne vlere enorme prej: 14,250.00 euro.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 11, 59, 60, 69 , të LPP –së, si dhe 42 dhe 60 te rregullores se prokurimit publik. Duke propozuar që ankesën ta aprovoi pretendimet tona ankimore dhe lenden ta kthejë ne rivlerësim.

Përgjegjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim: Operatori ekonomik. me datë 14.11.2023 ora 22:23 ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim në AK- Komunën e Gjilanit kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të dt. 13.10.2023 në relacion me dhënien e kontratës OE të kualifikuar dhe diskualifikimin e tij si tenderues i pakualifikuar sipas Letrës Standarde për Tenderuesin e Pakualifikuar rreth fazës së Parë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " Furnizim me karrikat Stomatologjike dhe pajisje tjera" me nr. të prokurimit: 651-23-10457-1-2-1, duke kërkuar rishqyrtimin e vendimit të AK-se. Pasi që AK e ka pranuar Kërkesën për Rishqyrtim të parashtruar nga OE "LETAMED SH.P.K" e ka pezulluar menjëherë procedurën e prokurimit dhe i ka njoftuar me shkrim të gjitha palët përmes platformës e-prokurimi. Autoriteti Kontraktues, Komuna e Gjilanit, Kërkesën për Rishqyrtim të OE ankues "LETAMED SH.P.K" e ka shqyrtuar konform paragrafit 6 të nenit IOWA të LPP-së. Me rastin e shqyrtimit paraprak, Autoriteti Kontraktues konstatoi se, kërkesa në rastin konkret i përmban të dhënat sipas paragrafit 3 të nenit 60 të Rregullores Nr.001/2022, por e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim në kundërshtim me paragrafin 7 në pikën (a) të nenit 42 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik e cila përcakton se, nëse njoftimi publikohet në ditën e premtë, afati kohor për parashtrim të ankesës fillon ditën e premtë sepse:

a. Dita e premtë është ditë pune.

- Konstatimet e AK-së bazuar në faktet dhe rrethanat e rastit

Me datën 13.09.2023 (ditë e premte), Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit e ka marrë dhe publikuar në platformën elektronike e-prokurimi Njoftim Vendimin e Autoritetit Kontraktues të shoqëruar me letrat standarde në relacion me tenderuesit për aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me karrika Stomatologjike dhe pajisje tjera" me nr. të prokurimit: 651-23-10457-1-2-1, inicuar nga AK-Komuna e Gjilanit.

Me datën 14.11.2023 Ora 22:23 parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim OE" LETAMED SI•I.P.K".

,kundër vendimit të lartcekur ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim te Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit. Parashtruesi i kërkesës e konteston vendimin e AK-së në relacion me njoftimin e vendimit për dhënien e kontratës OE të kualifikuar rreth fazës së parë dhe refuzimit të tenderit të tij si i pakualifikuar.

Në bazë të nenit 60 paragrafi I i Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022 LPP-së i lidhur me nenin I OWA paragrafi 3.2 i LPP-së, që ka të bëjë me paraprake të mosmarrëveshjeve, respektivisht paraqitjes të kërkesës për rishqyrtim dhe afatet kohore, përcakton se kërkesa për rishqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, brenda afateve të mëposhtme:

- b) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (I358) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0).

NE bazë të nenit 42 i Rregullores për Prokurim Publik Nr.001 /2022 LPP-së (njoftimi i tenderuesve/kandidatëve) duke ju referuar fillimit të afatit kohor për parashtrim te ankesave në rastet kur Njoftimi mbi Vendimin e AK përmes Formularit B58 publikohet te ditën e premte, ka përcaktuar në mënyrë implicite se:

- Paragrafi 7: Nëse njoftimi publikohet ne ditën e premte, afati kohor për parashtrim të ankesës fillon ditën e premte sepse:

a. Dita e premte është dite pune

Kurse sipas nenit 5 (Kalkulimi i afateve kohore) te LPP-së përcaktohet se:

1. Afatet kohore te këtij ligji duhet të fillojnë ne një dite pune dhe të përfundojnë ne një dite pune. Afati kohor i shkon deri ne 16:00 ne ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo me herët se ne ora 12:00 të ditës së skadimit.
2. TE shtunave, te dielave dhe festave zyrtare do te llogariten është kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie ne një të shtunë, një të diel ose ne një feste zyrtare afati kohor do te zgjatet për të përfshirë ditën e pare të punës pas kësaj.

Ne këtë kuptim, marr parasysh faktin se data e publikimit/ngritjes ne platformën elektronike të prokurimit të Njoftim Vendimit të AK-së B58 ka ndodh te publikohet ne ditën e premte me datë

22.09.2023, bazuar ne paragrafin 7 të nenit 42 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik lidhur me paragrafin I të nenit 5 të LPP-së ku përcaktohet se "afatet kohore të këtij ligji duhet te fillojnë ne një dite pune dhe të përfundojnë ne një dite pune", Llogaritja e fillimit të afatit ligjor fillon nga dita e premte e datës 22.09.2023 si datë/ditë kur është publikuar Njoftim Vendimit të AK-së B58. Andaj nisur rrethanat e lartcekura të rastit konkret, dita e premte e datës 13.10.2023 Është dita I e fillimi i afatit ligjor kurse afati i fundit i ditës 5 për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim pranë AK-së ka qenë data 17.10.2023 apo dita e marte deri në ora 16:00.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lart, AK konstaton se situata e lartcekur vërteton se Kërkesa për Rishqyrtim e parashtruar me datë 18.10.2023 nga OE "LETAMED SII.P.K dhe e dorëzuar pranë AK-së kundër Njoftim Vendimit te Autoritetit për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me karrika Stomatologjike dhe pajisje tjera “më nr. të prokurimit: 651-23-10457-1-2-láshtg parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar në rrethanat sipas nenit 42 paragrafi 7 pika (a) te Rregullores Nr.001/2022, andaj e njëjta hedhet si e palejueshme dhe nuk mund të hyn në shqyrtim për çështjen kryesore nga AK dhe rrjedhimisht OSHP. Për më tepër lidhur me çështjen e njëjta përkitazi meLlogaritjen e fillimin e afatit ligjor nga dita e premte (dita I e afatit ligjor) shih vendimin e marrë nga AK Spitali i Përgjithshëm "Isa Grezda" ne Gjakovë për aktivitetin me numër prokurimi me titull: "Furnizim me inventar të Kuzhinës" nr. prokurimi: 70020-6514-1-2-1, i cili pastaj për këtë çështje është vërtetuar nga OSHP me vendimin PSH.nr. 997/20 i cili ka formën e plotfuqishme.Por pavarësisht faktit se për një ankesë e parashtruar pas afatit ligjor AK nuk ka obligim te lëshohet në vlerësimin meritor te pretendimeve ankimore, AK duke u nisur nga parimi barazisë, mos diskriminimit dhe zgjidhjes së drejtë e të ligjshme të lendes, i ka shqyrtuar në mënyrë meritorë të gjitha pretendimet e OE ankues "LETAMED SH.P.K” Andaj pas shqyrtimit dhe analizimit të thënieve dhe secilit pretendim të parashtruar në kërkesën për rishqyrtim ne relacion me shkresat e lendes në këtë qeshtje administrative duke përfshirë dëshmitë tjera të siguruara gjatë procedimit të rivlerësimit, AK të njëjtat i vlerësoi si te pabazuara dhe pa ndikim për vendosje ndryshe ne këtë çështje juridike sepse vlerësimi i aplikacioneve, respektivisht vendimmarrja është bërë duke u bazuar konform kriterëve të specifikuara ne dosjen e tenderit/njoftimit për kontratë dhe zbatimit të në mënyrë të drejtë, të ligjshëm të dispozitave përkatëse të LPP dhe Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Pretendimi ankimor : "Komisioni Profesional për ekzaminimin dhe Vlerësimin e ofertave konstaton se GOE te ofertimit te fazës se para kualifikimit nuk ka përmbushur piken 6 dhe 8 ne kapacitetin profesional dhe kapacitetin tekniko-profesional, ku ne DT është kërkuar te ketë inxhinier i diplomuar I ndërtimtarisë drejtimi arkitekture (I certifikuar fidic) ndërsa GOE ne fjalë nuk e ka përmbushur ketë pike duke ofruar ing te ndërtimtarisë, rrjedhimisht konstatohet se GOE nuk ka përmbushur dhe nuk kualifikohet për fazën e dyte". Në lidhje me këtë arsyetim ju sqarojmë se kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë "Një udhëheqës i punishtes Inxhinier I

diplomuar ose master i Arkitekturës, i certifikuar me FIDIC dhe i certifikuar për auditim të energjisë në ndërtesa sipas standardit DIN EN 16247, me minimum 5 (pesë) vite përvojë pune nga data e diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr së paku një kontratë të natyrës së ngjashme ndertimi lartë", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "Dëshmia 2.Lista e stafit profesional dhe e punëtorëve duhet të dorëzohet në origjinal e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Kontrata ose para kontratat valide për projektin në fjalë, cv, diploma e noterizuara, vendimet për caktimin e detyrave të jenë të nënshkruar a nga dy palët (për stafin i cili nuk është në listën e pagave, para kontratat duhet të jenë të noterizuara) referenca të natyrës së ngjashme". Për kërkesën e lartcekur ne kemi prezantuar në ofertë inxhinierin e diplomuar z. Sali Fazliu i cili është inxhinier dhe Magjistër i shkencave teknike-Ndërtimtarisë, pra i njëjti është i diplomuar me sistemin 5 2. Përderisa kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë Një udhëheqës i punishtes Inxhinier i diplomuar OSE master i Arkitekturës, atëherë kuptohet qartë se inxhinieri i prezantuar nga ne është konform kërkesës së lartcekur. Autoriteti kontraktues e ka cekur qartë të prezantohet një inxhinier i diplomuar OSE master i arkitekturës, andaj nga ky fakt 4/3 F02 Formulari Standard për rishqyrtim te vendimit ne AK kuptohet se ne e kemi prezantuar inxhinierin e diplomuar, ashtu siç është përcaktuar me kërkesën e lartcekur. Inxhinieri i prezantuar nga ana jonë i posedon të certifikimet që janë kërkuar në dosje të tenderit, andaj mos kualifikimi ynë në fazën tjetër, është i padrejtë, në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njëkohësisht i pa mbështetur në dispozita Në këtë rast përderisa është lejuar të prezantohet një inxhinier i diplomuar ose një master i arkitekturës dhe ne e kemi prezantuar inxhinierin sipas kërkesës atëherë, nuk mund dhe nuk është dashur të eliminohemi nga konkurrenca me një arsyetim të tillë. Përgjigje në pretendimin fillestar (historia procedurale e çështjes së aktivitetit në fjalë)

Komisioni profesional për ekzaminimin dhe vlerësimin e ofertave ka konstatuar se GOE ofertimit te fazës se para kualifikimit nuk keni përmbushur piken 6 dhe 8 ne kapacitetin profesional dhe kapacitetin tekniko-profesional, ku ne DT është kërkuar te ketë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi arkitekture (i certifikuar fidic) ndërsa ju si GOE nuk e keni përmbushur këtë pike duke ofruar ing te ndërtimtarisë, rrjedhimisht konstatohet se GOE nuk ka përmbushur dhe nuk kualifikohet për fazën e dytë.Ku, dhe si përfundim ne si AK — Autoritet Kontraktues qëndrojmë mbrapa Njoftimit të AK si dhe Letrave Standarde të datës 13.10.2023.Përgjigjia e AK lidhur me këto pretendim është se ;Bazuar në të lartcekura, AK konsideron se gjatë rivlerësimit ka vepruar në pajtim të plotë me dispozitat e nenit 59, 60 dhe 61 lidhur me nenin 1, 6 dhe 7 të LPP-së dhe dispozitave përkatëse të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik duke bërë zgjidhjen e duhur përkitazi me OE të cilët janë të shpallur si OE të kualifikuar për të vazhduar me fazën e dytë të këtij aktiviteti të Prokurimit Gjithashtu AK konsideron se pretendimet e OE ankues nuk kanë bazë argumentuese dhe provuese që aktiviteti të kthehet në rivlerësim sepse kthimi i një aktiviteti në rivlerësim pa bazë ligjore është në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik (drejtësia/mos diskriminimi, efikasiteti & efektiviteti, ekonomikiteti, konkurrenca) dhe me nenin I dhe 6 të LPP-së.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 27/11/2023 ka autorizuar eksperten shqyrtuese për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 942/23, ndërsa me datë 29/11/2023 është dorëzuar raporti

i ekspertës shqyrtuese me nr. 2023/0942 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertës shqyrtuese, ndërsa OE nuk ka kthyer përgjigje rreth raportit të ekspertës shqyrtuese.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertës, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “**Letamed SH.P.K.**”- **Suharekë**, ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr. 2023/0942 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim : “Aktiviteti i prokurimit: “Furnizim me karrikat Stomatologjike dhe pajisje tjera” me nr. të prokurimit: “ 651-23-10457-1-2-1 ”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN, ka filluar me publikimin e njoftimit për kontratë me datë 05.10.2023, procedurë e hapur, hapja e ofertave është bërë me datë 26.10.2023, njoftimi mbi vendimin e AK-së 10.11.2023. OE ankuesi shpallet i eliminuar. Pas refuzimit të përgjigjes nga AK, me datë 24.11.2023 parashtron ankesë në OSHP, duke pretenduar se OE i rekomanduar nuk i plotëson kriteret ekonomike, teknike dhe profesionale, dhe se është i pa përgjegjshëm. I njëjti pretendon se AK nuk ka vlerësuar ofertat konform LPP-së përkatësisht: Nenin 1,6,7,11,59,69 si dhe nenin 42 dhe 60 të rregullores 001/2022 për prokurim publik.”

Pretendimi Nr.1 “Fillimisht pretendimi ynë ankimor ka të bëjë me atë që KERKESEN PER RISHQYRTIM të cilën ne e kemi dorëzuar me date: 14.11.2023, AK na ka refuzuar si kërkesë jashtë afatit !!! Vendimi i AK është publikuar me date: 10.11.2023, (Dite e premtë), dita zero (0), dhe konform Rregullores për prokurim publik (neni 42.7), nëse Vendimi ka të bëjë me dhënie, dhe i njëjti publikohet ditën e premtë numërimi fillon nga dita e premtë si dite zero (0). Afati për dorëzim të kërkesave për rishqyrtim ka qene deri me date:15.11.2023, ndërsa ne kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim me date 14.11.2023, që i bie brenda afatit ligjor (një dite përpara). Pra AK ka bërë shkelje të nenit: 42 pika 7 të rregullores për prokurim publik.”

Përgjigje në pretendimin 1:Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe numërimit të afatit kohor lidhur me pretendimin e OE ankues për hedhjen si të jashtë afatshme të kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-së sqaron se, AK ka publikuar vendimin me date 10.11.2023 14:40h, OE ankuesi ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim me date 14.11.2023 22:23h (data valide 15.11.2023), tutje AK ka publikuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim me date 16.11.2023

10:30h (hedhet si e jashtë afatshme), ndërsa me date 27.11.2023 10:33h është pranuar ankesa në OSHP.

RRPP 001/2023: 10.11 dita (0,)11.11. dita (1), , 12.11. dita (2) , 13.11 dita (3), 14.11.dita (4), 15.11. dita (5) Si e tillë kërkesa e OE ankuesit pranë AK-së ka qenë brenda afatit kohor 5 ditë, andaj **pretendimi I OE ankues gjendet I bazuar.**

Pretendimi Nr.2 Qasja e ofruar nuk është konform nenit 11 te LPP-se, sepse OE ne ANEKS3 te DT ka plotësuar kërkesën ku ka specifikuar se dokumentet si sekret afarist janë: 1.Autorizimet, 2.Katalogjet dhe 3.Lista e projekteve. Pra vete OE ne këtë aneks, si sekret afarist i ka vlerësuar vetëm 3 dokumente, ndërsa ne procesverbalin e datës 14.11.2023 për qasjen e ofruar, shihet se AK nuk na ka dhënë qasjen ne asnjë prej dëshmimeve te tjera. Nëse kërkesa ishte për këto tri dokumente, atëherë pse AK nuk na ka ofruar qasjen për dëshmitë tjera. Ne natyrisht se e kemi përgjigjen për këtë qeshtje te cilën po ua prezantojmë ne pretendimet ne vazhdim.

Përgjigje në pretendimin 2: “**Ekspertja Shqyrtuese** sa i përket pretendimit të dytë sqaron se, OE i rekomanduar në ofertë ka të bashkangjitur kërkesën për konfidencialitet, si dhe Aneks 3, AK nuk ka dhënë qasje në dokumentet e klasifikuara, por ky i fundit ka sqaruar që OE ankuesi ka poseduar qasjen citat: Si e tillë **pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar.**

Pretendimi Nr.3 “Ne si OE i cili kemi ofruar çmimin me te lire nga te gjithë OE, përveç qe kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-se, po ashtu ju kemi përmbajtur dhe kemi plotësuar te gjitha kërkesat për specifikimet teknike të kërkuara, duke ofruar dëshmitë, nga të cilat AK ka munde te vërej se pajisjet e ofruara nga ne, janë konform specifikimeve teknike të kërkuara ne dosje te tenderit. Pra AK me refuzimin e ofertes sone, si OE i përgjegjshëm me çmimin me te lire, ka shpërblyer me kontrate një OE me çmimin me të shtrejt se te gjithë OE ne këtë procedure dhe ka DEMTUAR buxhetin e tije ne vlere prej: 14,250.00 euro.

Përgjigje në pretendimin 3: “**Ekspertja Shqyrtuese** lidhur me arsyen e eliminimit të OE ankues sqaron se, pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës konsideroj se arsyeja e eliminimit nga AK është e qëndrueshme, për faktin se, AK në DT tek specifikat teknike ka kërkuar:

1. Karrige stomatologjike: Parametrat standard , Karrige stomatologjike me lëvizje automatike në drejtim lartë-poshtë, para-mbrapa, Tre komanda: Në papuçe; Në trepanën kryesore , Në trepanën asistuese , Rregullator ajri+filtri, Rregullator uji+filtri , Negativoskop të inkorporuar , Shishe uji të inkorporuar, Ujë te nxehtë, Mbështjellësi i karriges prej materialit te qëndrueshëm dhe gjatesia e ulese / karriges 200cm , Fontanë qeramike me mundësi rrotullimi 180 shkallë , Panel kryesor rrotullues me hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e instrumenteve terapeutike, Lamp Max Lux: ≥25000Lux and Min Lux: ≤3000Lux , Kolor Temp.: 5000-5300K/2700-3200K, , Boshti me fontanë të ketë mundësi rrotullimi 180 shkallë Paneli kryesor i përshtatshëm për mbajtjen e instrumenteve rrotulluese të punës, Paneli rrotullues asistues i cili ka shumicën e funksioneve të panelit kryesor, Trepan kryesore e përshtatshme me dimensione për mbajtjen e instrumenteve terapeutike , Trepana kryesore të ketë 5 çerdhe (zona) për mbajtjen e instrumenteve rrotulluese

të punës, Duhet të ketë: 2 turbinë, 1 kundërkand me mikromotor , 1 pjesament , 2 puster dhe 1 kavitron të inkuorporuar, Karriga per stomatologe, Trepana asistuese me komanda të trepanës kryesore dhe të ketë të inkuorporuar helio llambë me program për polimerizim, thithëse pështyme, aspirator kirurgjik,puster., Parametrat teknike, Tensioni i hyrjes: AC220V-230V, Presioni i ujit: 0,20-0,40Mpa/2,0-4,0bar, Presioni i ajrit: 0,55-0,80Mpa/5,5-8,0bar , Prodhimi: ≥ 55 L/min (vakum uji) dhe ≥ 55 L/min (vakum ajri), Pesha: 255 kg . **Kurse në ofertën e OE ankuesit gjendet katalogu për karrigen stomatologjike me vetëm këto specifika: si ne foto.**

Nëse e krahasojmë vetëm tek pesha e cila është kërkuar, vërejmë se OE ankuesi ka sjellë një karrige me peshë **180KG** ndërsa është kërkuar **225 KG**, tek presioni I ajrit, kërkohe limit 0.55-0.80 Mpa ndërsa OE ankuesi sjellë pa limit prej 0.55Mpa, të cilën AK nuk ia merr të mirëqenë. **2. Air Kompresori: AK- citat” I mungojnë disa specifika të prezantuara ashtu siç janë kërkuar tek Aneksi 1 të DT-së”**Ekspertja Shqyrtuese sqaron, AK në DT ka kërkuar: Furnizimi me rrymë: 230V/50Hz -2.2Kw(3HP) , 1400 rrotullime për min. (RPM), Shtypja:8Bar , Rrjedha e airt(Air Flow) 608L/min., Kapaciteti: Tank 120Lt , Zhurma: 56dB , HP : dhe KW:4 dhe 3Kw, Dimensiononi 1220x55x910mm. **Pesha 120kg .**

Kurse OE ankuesi në ofertë bashkangjitur posedon: foto

Si e tillë, OE ankuesi sjellë air kompresorin me peshë më të vogël 112 KG ndërsa është kërkuar 120kg, niveli i zhurmës nuk është i specifikuar fix, si dhe disa specifika të tjera të cilat mund të krahasohen si më lartë. **3. Tavolinë për teknik për dy persona 215 cm:AK në DT ka kërkuar:** Trupi i tavolinës është prej metali 1mm Dkp, Tavilina duhet të ketë dritën led mbi tavolinë për ndriçim 36w, Boshtet e sirtarëve janë prej metali 1mm Dkp, Duhet ti ketë 2 sirtarë për person në tavolinë të punës dhe 4 sirtarë për persona anash (2+2+4+4=12 copa), Sistem e sirtarëve me kushineta, Këmbët e tavolinës janë profil hekuri me trashësi 50x50x1,50 mm, Te jetë rezistencë në 200 gradë, e lyer me ngjyrë të bardha elektrostatische, Mbulesa e përparme e rafteve dhe sirtarëve të tavolinës 30 mm 18 mm Laminat special me presion rezistent ndaj gërvishtjeve dhe nxehtësisë , Të ketë një linjë tokësore në tavolina dhe instalimin elektrik të mobiluar me kabllo 3x1.5 mm, Të ketë Instalimi i gazit është tub bakri 6 mm, Valvula e daljes së gazit në tryezë/ tavolinë, Te ke ketë dy aspirator / vakum sistem për thithje për persona 1200w, **Sistemi i ajrit nga zorrë silikon rezistente ndaj presionit 6 mm, Kurse OE ankuesi në katalog specifikat e tavolinës i posedon si më poshtë: foto**

4. Pajisja sterilizuese e ajrit të thatë 40 LT Digjital:AK në DT ka kërkuar: Termostati: 50 C 300 C, Ndjeshmëria: +- 5% , Rezistenca: 550 W, Vëllimi i brendshëm: 40 Lt., Përdorimi për shumë qëllime, Termostat i rregullueshëm, 120 min. Kohëmatës, Kohëmatësi mund të kthehet në drejtim të kundërt për përdorim të pakufizuar, Ekran dixhital i temperaturës, Përmasat e jashtme: Gjerësia: 68cm Lartësia: 50cm Thellësia: 45.5cm. , Përmasat e brendshme: Gjerësia: 40cm Lartësia: 34cm Thellësia:30cm. **Kurse OE ankuesi në ofertë ka të bashkangjitur:**

Si e tillë, OE ankuesi në katalog nuk posedon të gjitha specifikat konform kërkesës së AK-së në DT, nëse e krahasojmë vetëm dimensionet shohim që OE ankuesi në katalog posedon dimensionet

tjera; Sipas sqarimeve më lartë, vërejmë se, arsyet e eliminimit të OE ankues nga AK konsideroj se janë të qëndrueshme dhe **pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar.**”

Pretendimi Nr.4 OE i rekomanduar, përkundër qe AK nuk na ka ofruar qasje, por ne e njohim si konkurent dhe ne disa AK (si shembull ne AK Komuna Rahovec) kemi patur qasje ne ofertën e këtij OE dhe ky OE te cilin Komuna e Gjilanit e ka propozuar për kontrate, ka ofruar Autorizimin nga prodhuesi - nga një PRODHUES tjetër, ndërsa Certifikatat ISO dhe CE, i ka te një Prodhuesi tjetër. Pra nëse Komuna do ta bënte vlerësimin konform nenit 59 te LPP-se, do ta vërente se AUTORIZIMI, KATALOGU dhe Certifikatat ISO se bashku me CE Certifikatat nuk përputhen sepse janë te prodhuesve te ndryshëm.

Përgjigje në pretendimin 4:Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, OE ankuesi pretendon se OE i rekomanduar nuk i ka autorizimin dhe certifikatat ISO dhe CE nga i njëjti prodhues, mirëpo në ofertën e OE të rekomanduar për secilën pajisje me katalog, ka të bashkangjitur edhe autorizimin për të njëjtat, ndërsa Iso standardet nuk janë kërkuar nga AK andaj edhe nuk janë bashkangjitur në ofertë. Si e tillë **pretendimi i OE ankues kundër OE të rekomanduarit nuk gjendet i bazuar dhe i qëndrueshëm.Si përfundim,** pretendimi i OE ankues kundër OE të rekomanduarit **nuk gjendet i qëndrueshëm, gjithashtu arsye e eliminimit të të njëjtit gjenden të bazuara dhe të qëndrueshme,** kurse tek pretendimi i parë lidhur me refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, si rrjedhojë meqenëse nuk paraqet ndryshim në vendimin përfundimtar, atëherë si e tillë **rekomandoj që të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.**”

Sipas të thënave më sipër, ekspertja shqyrtuese i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues **“Letamed SH.P.K.”- Suharekë,** Argumentimi në raportin e ekspertës shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertës shqyrtuese. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjen e dhënë nga OE ankues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues **“Letamed SH.P.K.”- Suharekë, te pa bazuara.**

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësas e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritot. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në këtë rast.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertës shqyrtuese dhe mendimi i saj janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e saj me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertës shqyrtuese, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertës shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Andaj, Paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës, Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i pabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur në konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- **OE - Letamed SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: